



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

**RELACION**  
**PËR MIRATIMIN E QIRASË MESATARE MUJORE TË BANESAVE NË TREGUNË**  
**LIRË**

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për strehimin , për zbatimin e politikave të strehimit për familjet e pastreha, kanë planifikuar fonde për financimin e bonusit të qirasë për vitin 2020, për qytetarët në nevoje për strehim.

Kjo nisur dhe nga fakti që ka shumë familje të pastreha që kërkojnë dhe plotësojnë kriteret për përfitim e bonusit të qirasë , pasi bashkia nuk ka apartamente të banesave sociale të lira .

Në zbatim të nenit 18 “Fondi publik i banesave sociale “ dhe nenit 19 “ Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik” të ligjit nr.22/2018 ‘Për strehimin social ‘ , që nga moment i hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk është shtuar me asnjë banesë.

Bashkia Berat bazuar në nenin 23 të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social “ ka bwrw njoftim me 23.12.2019 në faqen e bashkisë, për regjistrim në bashki të çdo subjekti privat që disponon banesë për ta dhënë me qira dhe për të ftuar statusin e “ pronarit social “, por në përfundim të afatit nuk u regjistrua asnjë subjekt .

Kërkesat e shumta për bonus qiraje shogërohen me vështirësi, për gjetjen e banesave në tregun e lire edhe pse ka shumë banesa bosh , pronarët e tyre hezitojne ti japin me qira , pasi nuk kanë besim te qiramarrësit se ata do të jenë korrekt në pagesat e konsumimit të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm dhe fika nga tatimi sidomos fakti që ata do të tatohen në vlerën 15% të çmimit të kontratës së qirasë/ mujore edhe pse nga ana jone jane sqaruar se përjashtohen nga ky tatim me ligji.

Mbështetur në vkm nr.459,datë 3.07.2019 “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, ne duhet të parqesim pranë M.F.E , kërkesat për bonus strehimi, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje dhe listën e detajuar të familjeve përftuese të miratuar me Vendimin të Këshillit Bashkiak.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

## PROJEKTVENDIM

### PËR MIRATIMIN E QIRASË MESATARE MUJORE TË BANESAVE NË TREGUN E LIRË

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, Sherbimeve dhe Pronave , mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni neni 8, 9, neni 24, neni 64 gërma c ; ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social ” nr.459,datë 3.07.2019 “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”

#### Propozon :

**1.** Miratimin e nivelit të qirase mesatare mujore të banesave në tregun e lirë sipas strukturës së apartamentit , si më poshtë:

- 1.Për apartament të tipit “Garsonierë” , për këtë strukturë nuk ka treg shifje pasi mungon.
- 2.Për apartament të tipit 1+1 13,000 lekë/muaj.
- 3.Për apartament të tipit 2+1 18,000 lekë/muaj.
4. Për apartament të tipit 3+1 22,000 lekë/muaj.

**2.**Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve, Transportit dhe Pronave .

KRYETARI I BASHKISË

